



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Prirje / Ditezuar / Prirje / Ditezuar / Prirje / Ditezuar	02.10.2023	3	viti / god / Veje
Organ / Njësia / Organ / Njësia / Organ / Njësia	No. Prot. / No. Prot. / No. Prot.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMSHICK	6362/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1085/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A nr.1085/2023, të datës 16.08.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1085/2023, e datës 16.08.2023, e parashtruar nga ankuesja në atë mënyrë që aprovohet si i bazuar pretendimi lidhur me të drejtën në shtesë tranzitore, ndërsa, refuzohet si i papabuar pretendimi lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës.
- II. **Obligohet** Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë plotësim ndryshimin e Akt Emërimit me numër protokoll 014/1/23, të datës 21.02.2023, ashtu që kategorizimi dhe koeficienti i pagës së ankueses për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, të përcaktohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
- III. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ankueses ti njeh të drejtën e shtesës tranzitore me listën e pagave të muajit tetor 2023 e tutje, si dhe kompensimin retroaktiv në emër të shtesës tranzitore për periudhën maj-shtator 2023.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje ankuesja), më datë 16.08.2023. ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5685/2023, të regjistruar nën shenjë A.nr.1085/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 20.07.2023 të Kryetarit të Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.08.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ndërsa, kjo e fundit, me datë 24.08.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5685/2023 të datës 16.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses me Nr.014 11/23 të datës 21.02.2023; Shkresën zyrtare me Nr.014 11/23 të datës 21.02.2023 lidhur me konfirmimin për përfundimin e konkurrimit tek SIMBNJ; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 13.02.2023; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Konkursin e datës 19.10.2022 me numër të referencës RN00010245; Vërtetimin e datës 02.03.2023 lidhur me përvojën e punës së ankueses; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Dëshminë lidhur me llogarinë bankare të ankueses të datës 15.02.2023 nga TEB Sh.A; Komunikimet elektronike të datës 24.04.2023, 19.04.2023, 09.03.2023, 06.03.2023, 02.03.2023 ndërmjet ankueses, Shefit të Departamentit të Administratës në ARKEP, Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Shefes së Sektorit të LP në Thesarin e Kosovës lidhur me lëndën e ankueses; Listën lidhur me të dhënat për pagën e ankueses të datës 19.04.2023; Shkresën zyrtare me Nr.Prot.1759 të datës 08.03.2023 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Thesari i Kosovës lidhur me informatat për pagat bazuar në Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë për të gjitha organizatat buxhetore; Shkresën zyrtare me Nr.3 të datës 07.04.2023 lidhur me opinionin ligjor dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.08.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 24.08.2023 nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Komunikimin elektronik të datës 20.03.2023 ndërmjet Shefit të Departamentit të Administratës në ARKEP dhe Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Kërkesën për aprovim të pozitive për katalog me Nr.081/2/23 të datës 20.03.2023 nga Shefi i Departamentit të Administratës në ARKEP për Drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Listën e punonjësve të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP); Listën e pagave të ankueses për muajin prill, maj dhe qershor të vitit 2023; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 06.03.2023 për ankuesen; Komunikimet elektronike të datës 19.05.2023, 17.05.2023, 15.04.2023 ndërmjet Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Shefit të Departamentit të Administratës në ARKEP dhe zyrtarëve gjegjës; Kërkesën e ankueses me Nr.094/1/23 të datës 13.07.2023 lidhur me nivelizimin e pagës për tek Kryetari i Bordit të ARKEP; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.07.2023 nga Kryetari i Bordit të ARKEP për ankuesen; Komunikimin elektronik të datës 13.07.2023 ndërmjet personave gjegjës të ARKEP lidhur me kërkesën e ankueses për nivelizim të pagës; Akt emërimit e ankueses të datës 27.07.2012 në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Akt emërimit e ankueses të datës 18.07.2016 në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, shkrese nga SIMMBJ-Lista e rezultateve përfundimtare e datës 13.02.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses

“shtë e pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesja ka qenë e punësuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, dhe së e njëjta kishte aplikuar në Konkursin me numër reference RN00010245 për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën e punës Drejtor i Departamentit Ligjor, i shpallur më datë 19.10.2022, nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Me tej, nga shkresat e lëndës rrjedhë se ankuesja me datë 13.02.2023, është përzgjedhur si kandidat e suksesshme për pozitën e punës Drejtor i Departamentit Ligjor në ARKEP, ndërsa, më datë 21.02.2023 i është lëshuar Akti i Emërimit me numër protokollit 21.02.2023, për vendin e punës më titull Drejtor i Departamentit Ligjor, Kategoria “Drejtues i mesëm 1”, koeficient të pagës 1131.25 euro.

Ankuesja me datë 13.07.2023 përmes kërkesës me Nr.094/1/23 i është drejtuar Kryetarit të Bordit në ARKE-it, lidhur me nivelizimin e pagës si dhe zbatimin e shtesës tranzitore në mënyrë që të barazohet paga e saj me atë të shefave të departamenteve tjera, konkretisht t’i zbatohet Akt emërimi i nënshkruar me numër 014/1/23 i datës 21.02.2023, sipas të cilit është paraparë paga bruto 1131.25 euro.

Kryetari i Bordit në ARKEP me datë 20.07.2023 përmes e-mailit zyrtar, ka njoftuar ankuesen se me datë 09.03.2023 institucioni në fjalë ka dërguar kërkesën për ekzekutimin e pagës në Thesarin e Kosovës, mirëpo, e njëjta është refuzuar nga kjo e fundit me arsyetimin se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është kërkuar që të merret aprovim nga ana e DMZP-së. Pas marrjes së njoftimit nga DMZP-ja me datën 19.04.2023, institucioni i punësimit ka njoftuar se ankuesja është pozicionuar me koeficient 8.4 si Drejtues i Mesëm.

Kolegji i Këshillit, në vështrim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses analizoi bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses, gjegjësisht nenin 40 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik më të cilin përcaktohet se: *“1. Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë. 2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore”.*

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë, secilit nëpunës i garantohet shtesa tranzitore, nëse para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i njëjti ka realizuar pagë më të lartë se paga e përcaktuar me këtë ligj, në atë mënyrë që në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nëpunësi realizon shtesën tranzitore në vlerë prej 100%, në vitin e dytë më vlerë prej 50%, dhe nga viti i tretë nëpunësi civil përfiton pagë sipas këtij ligji.

Për sa më sipër dhe duke u bazuar në provat materiale të çështjes është konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ka filluar me shpalljen e konkursit për Ngritje (avancim) në detyrë, me datë 19.10.2022, pra, para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe se e njëjta

procedurë kishte përfunduar sipas kushteve të shpalljes së konkursit. Andaj, duke qenë se procedura përmes të cilës ankuesja është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kishte filluar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë parimin e sigurisë juridike të materializuar edhe me dispozitat e nenit 157 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vlerëson se me të drejtë procedura ka vijuar dhe përfunduar sipas dispozitave të ligjit që ka qenë i zbatueshëm me rastin e fillimit të procedurës përkatëse, dhe se ankueses mbi këtë bazë i njihet e drejta në shtesë transitore siç përcaktohet me dispozitat e nenit 40 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i zbatueshëm nga data 05.02.2023), pagat dhe çdo kompensim tjetër përtej pagës bazë, realizohet vetëm në pajtim me dispozita e këtij ligj, rrejdhimisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është shfuqizuar çdo dispozitë ligjore që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji e që i referohen çështjes së pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e në këtë kontekst është shfuqizuar edhe rregullativa ligjore lidhur me pagat në ARKEP.

Ndërlidhur me konstatimin si më sipër Kolegji i Këshillit i ‘u referua nenit 1 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik me të cilin është përcaktuar se: ***Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë***, nenit 2 të të njëjtit ligj i cili parasheh se: “*Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë... “ si dhe nenit 45 paragrafi 2 “ ... ***2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligj***”, nisur nga ky përcaktim ligjor Kolegji i Këshillit vlerëson se Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka vendosur rregulla unike lidhur me pagat dhe kompensimet tjera, për të gjithë të punësuarit në sektorin publik (përjashtimisht institucionit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës), duke u bazuar në parimet e ligjshmërisë, barazisë, mos diskriminimit si dhe transparencës, kështu që çdo realizim i pagave dhe kompensimeve jashtë rregullimit ligjor të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik bie ndesh me dispozitat e të këtij ligji.*


Nisur nga rrethanat faktike dhe ligjore si me lartë, Kolegji konstaton se është i pabazuar pretendimi ankimor i ankueses lidhur me harmonizimin e pagës, sepse, ankuesja në pozitën e punës Drejtor i Departamentit Ligjor realizon pagë bazë në pajtim me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe atë në grupin, klasën dhe koeficientin përkatës, mirëpo siç u konstatua me sipër, ankuesja gëzon të drejtën e kompensimit të shtesës transitore nën kushtet e përcaktuar me nenin 40 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe atë mbi bazën e diferencës së koeficientit të pagës i aplikueshëm për këtë pozitë në kohën e shpalljes së konkursit RN00010245, të datës 19.10.2022, kështu që pretendimi ankimor në këtë kontekst është i bazuar.

Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit, duke obliguar Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që në afatin e përcaktuar si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Akt Emërimit me numër protokollit 014/1/23, të datës 21.02.2023, ashtu që kategorizimi i pozitës dhe koeficienti i pagës së ankueses për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, të përcaktohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, kurse obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës që në afatin e përcaktuar si në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi, ankueses ti njeh të drejtën e shtesës tranzitore me listën e pagave të muajit tetor 2023 e tutje, si dhe kompensimin retroaktiv në emër të shtesës tranzitore për periudhën maj-shtator 2023.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1085/2023

Ardita Perçaku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës,
- Bordit të ARKEP-it;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në ARKEP-it, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

